

## POLICIES AND MANAGEMENT IN THE FIELD OF SECURITY IN KOSOVO

**Feim Brava**

College UBT Prishtina, Kosovo [feimbrava@hotmail.com](mailto:feimbrava@hotmail.com)

**Abstract:** Writing for security and security policies in Kosovo is a special pleasure. As it is well known, the Republic of Kosovo is one of the newest states in the world since it was separated from the Republic of Serbia in 1999 after the NATO military intervention, internationally recognized as an independent state from 116 countries around the world it should be noted that only 23 European Union countries have been recognized as independent states by 28 as the EU has.

Kosovo as a new country with about 1.8 million people has had great achievements in the field of national security. A serious problem is the non-recognition of Kosovo as an independent state from five European countries (Spain, Greece, Slovakia, Cyprus and Romania), problems which continue to this day because of Kosovo's need for support from these countries around the membership in International Security Organizations, where their vote is very important.

Another challenge is the consequence of the first problem and not having the opportunity for the new state to join international security organizations (such as Europol, Interpol), mainly due to non-recognition by the five European countries, which mentioned above.

A very important element is the control of Kosovo's territory by Kosovo's security forces, which is a constant challenge but with many achievements.

It is worth pointing out that Kosovo's security organs are very well formed.

The socio-economic situation and the global crisis that has affected especially Balkan countries, Kosovo is still in the process of pursuing its goals for its citizens and high security for foreign visitors.

**Keywords:** Security, politics, Kosovo, territories.

## POLITIKAT DHE MENAXHIMI I SIGURISË NË KOSOVË

**Feim Brava**

Kolegji UBT Prishtinë, [feimbrava@hotmail.com](mailto:feimbrava@hotmail.com)

**Abstrakt:** Të shkruash për sigurinë dhe politikat e sigurisë në Kosovë është knaqësi e veçantë. Siç dihet Republika e Kosovës është ndër shtetet më të reja pothuajse në botë, pasi me luftë u nda nga Republika e Serbisë në vitin 1999, pas intervenimit ushtarak të NATO-s, e njohur ndërkombëtarisht si shtet i pavarur nga 116 shtete të botës,<sup>268</sup> ndër to, duhet të theksohet se vetëm 23 shtete të Bashkimit Evropian e kanë njohur si shtet i pavarur nga 28 sa ka BE-ja. Kosova si shtet i ri me rreth 1.8 milion banorë, ka bërë arritje të mëdha në fushën e sigurisë kombëtare.

Një problem serioz është mos-njohja e Kosovës si shtet i pavarur nga pesë shtete evropiane (Spanja, Greqia, Sllovakia, Qipro dhe Rumania), problem të cilat e përcjellin edhe sot e kësaj dite, për shkak të nevojës që ka Kosova për mbështetjen nga këto vende rreth anëtarimit në Organizata Ndërkombëtare të sigurisë, ku vota e tyre është shumë e rëndësishme.

Sfidë tjetër, është rrjedhojë e problemit të parë dhe mos pasjes mundësi që shteti i ri, të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare të sigurisë (siç janë Europol, Interpol), që kryesisht vijnë si pasojë e mos njohjes nga ana e pesë shteteve Evropiane, të cilat i përmendëm më lartë.

Element shumë i rëndësishëm është, kontrolli i territorit të Kosovës, nga organet e sigurisë së Kosovës që është sfidë e vazhdueshme por me shumë arritje.

Vlenë të theksohet se organet e sigurisë së Kosovës janë shumë të formuara mirë.

Gjendja socio-ekonomike dhe kriza e globale, që ka prekur të gjithë sidomos shtetet e Ballkanit, përderisa Kosova pamarrë parasysh vazhdon me synime për jëtë më të mirë për qytetaret e vet dhe siguri të lartë për vizitorët e huaj.

**Fjalët kyçe:** Siguria, politika, Kosova, teritoret.

---

<sup>268</sup> Ministrisë së Jashtme të Kosovës

## HYRJE

Është problem mos njohja e Kosovës nga pesë shtete Evropiane, është shumë e dukshme, kur kemi parasysh faktin se asnjë marrëveshje kontraktuale pothuajse nuk e ka si shtet me BE-në, duke patur parasysh kompleksitetin ligjor e funksional, nëpër të cilat duhet të kalohet deri në antarësim, brenda BE-së.

Kjo sjellë mos koordinim dhe mos pasje qasje në asnjë organizatë të sigurisë brenda Bashkimit Evropian, e që është hendikep i madh sa u përket bashkërendimit të politikave në aspektin e sigurisë në aspekt më të gjërë, duke patur këtu parasysh edhe bashkëpunimet ndërkufitare, e lëre me bashkëpunime dhe me të thella.

Siç dihet, në Kosovë me 12 qershor ka mbaruar lufta e fundit nëpër të cilën vendi kaloi. Në këtë datë, në territorin e Kosovës janë vendosur trupat e NATO-s, të quajtura KFOR, forcë kjo ushtarake ndërkombëtare që edhe sot operon brenda territorit të shtetit dhe është përgjegjëse për sigurinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara dhe në bazë të marrëveshjes tekniko-ushtarake të Kumanovës.

Kjo forcë ushtarake, ka mandat të krijojë dhe ruajë sigurinë e qytetarëve të Kosovës dhe nq të njejtën kohë t'i kontrollojë dhe mbikëqyre kufijtë e Kosovës.

Duhet të theksohet se kjo forcë ushtarake, ka mandat të operojë brenda territorit të Kosovës, por duhet të kemi parasysh se Kosova sot ka nevojë imediate për anëtarësim në organizata ndërkombëtare të sigurisë siç e është Europol-i dhe Interpol-i, për arsye të rritjes së sigurisë në nivel ndërkombëtar, kur e kemi parasysh edhe kansosjen dhe problemeve të cilat kërcënojnë globin (terrozmizmi, trafikimi me qënje njerezore, trafikimi ndërkombëtar i narkotikëve etj).

Kontrolli i tërë territorit të Kosovës përbën sfidë në vete. Krijimi i Policisë së Kosovës, menjëherë pas luftës pra në vitin 1999, i dha mundësinë që Kosova të ketë për herë të parë pas çlirimit, të ketë institucionin e parë të sigurisë, i përbërë nga një forcë multietnike e trajnuar mirë nga Misioni i Kombeve të Bashkuara, i njohur me shkurtesën UNMIK (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë), i instaluar si një mision, i cili kishte për detyrë të krijonte komplet një administratë të re, përfshirë edhe atë të sigurisë.

Policia e Kosovës, sot ka për mision, mbajtjen e rendit dhe qetësisë, në tërë territorin e Kosovës.<sup>269</sup>

Një ndër sfidat e radhës është themelimi i Forcave të Armatosura, të shtetit më të ri, e që duhet patjetër ta përmendim. Forca e Sigurisë së Kosovës, e cila është krijuar në 21 janar të vitit 2009, pas shpërbërjes së TMK-së (Grupave Mbrojtëse të Kosovës) e cila ishte rrjedhojë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (pas demilitarizimit të kësaj të fundit). Kjo forcë numëron 4000 ushtarë aktiv dhe 2500 rezervë.

Kjo forcë e trajnuar mirë dhe e armatosur është trajnuar dhe vazhdon të trajnohet nga ekspertë të NATO-s, dhe në të ardhmen do të ketë një rol kyç në ruajtjen e paqes në rajon dhe antarsim të shpejtë në NATO.

Roli i FSK-së, sot gjithashtu është rol me mision kryesisht humanitar dhe reagim ndaj katastrofave humanitare që mund të godasin Kosoven, por edhe për rolin për të cilin është e thirrur, pra atë të sigurisë së Kosovës.<sup>270</sup>

Vlenë të cekët se policia e Kosovës bashkë me agjensinë e intelgjencës së Kosovës, kanë bërë punë jashtëzakonisht të mirë, duke bërë që këto grupe të zvogëlohen e që sot mund të konstatojmë se Kosova është ruajtëse dhe mbështetëse e sigurisë në rajon.

Në këtë pikë, prapë vijmë në konstatimin, se Kosova detyrimisht duhet të përfshihet brenda organizatave ndërkombëtare të sigurisë, përmes së cilave mundësitë për shkëmbim të informacionit, koordinim dhe komunikim do të përbënin element të rëndësishëm në fushën e rrezikut jo vetëm nga dukuria e terrorizmit por edhe në parandalimin e shumë dukurive të cilat ndikojnë në aspektin e sigurisë në nivel global.

Mos të harrojmë se në Kosovë, ekziston që nga viti 2008 edhe një Mision i Bashkimit Evropian i ashtuquajtur EULEX.

Ky mision i BE-së, ka mandatë të mbështet institucionet relevante të sundimit të ligjit në Kosovë, ne rrugën e tyre drejt rritjes se efektivitetit, qëndrueshmërisë, multi-etnicitetit dhe llogaridhënies, të lira nga ndërhyrjet politike dhe në përputhje të plotë me praktikat më të mira të BE-së.

EULEX Kosova zbaton mandatin e saj, përmes shtyllës për monitorim dhe shtyllës Operative.

Tek shtylla e monitorimit, EULEX mbështet shërbimin korrektues të Kosovës, ndersa tek funksionet operative EULEX si reargues i dytë në fushën e sigurisë, ofron, mbështetje të vazhdueshme për të rritur dhe ndihmuar Policinë e Kosovës, në kontrollin e turmave në rast trazirash.

---

<sup>269</sup> <http://www.kosovopolice.com/>

<sup>270</sup> <http://www.mksf-ks.org/>

**ROLI I POLITIKËS NË RUAJTEN E SIGURISË NË KOSOVË**

Duhet të kemi parasysh se politikat e sigurisë duhet të jenë prioritet për çdo qeveri.

Të rëndësishme në këtë mes janë Siguria Nacionale dhe Siguria Humane. Vetëm si të përbashkëta, edhe Siguria Nacionale edhe Siguria Humane, mund të ndërtojnë një stabilitet dhe siguri të synuar.

Patjetër që prapë duhet të përmendim themelimin e Ushtrisë së Kosovës si një domosdoshmeri për të patur një stabilitet në Kosovë dhe në rajon, porse synimi kryesor duhet të jetë përmirësimi dhe promovimi i “sigurisë së butë”, që mbi të gjitha ka për qëllim kryesor sigurinë e individit, sigurinë ekonomike, sigurinë shëndetësore, sigurinë ushqimore, sigurinë e ambientit, sigurinë publike, sigurinë arsimore, sigurinë mbi privatësinë e individit, sigurinë profesionale, liritë civile, të drejtat e njeriut dhe fusha të ngajshme, që të gjitha këto çështje kryesore për çdo shtet janë kyçe e që Kosova ka bërë hapa të mahnitshëm.

Kosova siç edhe mund të shihet më lartë ka qëndrueshmeri politike, dhe në këtë mes institucionet dhe njerezit në teresi e kane një kuptim të sigurisë së mirëfilltë për qytetarët dhe të gjithë ata që e vizitojnë Kosovën që janë të mahnitur nga kjo dukuri.

Në këtë kuptim, institucionet e Kosovës dhe shoqëria në përgjithësi, krejt fokusin sa u përket çështjeve të sigurisë e orientojnë tek siguria në institucionet përkatëse, siç janë Policia, Ushtria dhe Agjencia e Intelejencës së Kosovës.

**SIGURIA HUMANE**

Janë një numër i madh i faktorëve që hyjnë brenda sigurisë njerëzore, duke përfshirë sigurinë ekonomike, shëndetësore, ushqimore, politike, mjedisore dhe personale.

Kofi Anan (2001), thotë: ”Siguria njerëzore, në kuptimin e saj më të gjërë, përfaqon shumë më tepër sesa mungesën e konfliktit të dhunshëm. Ajo përfshin të drejtat e njeriut, qeverisjen e mirë, qasjen në arsim dhe kujdesin shëndetësor dhe të siguruarit që secili individ ka mundësi dhe zgjedhje për të përmbushur potencialin e tij apo të saj. Çdo hap në këtë drejtim është gjithashtu një hap i madh drejt uljes së varfërisë, arritjes së rritjes ekonomike dhe parandalimit të konfliktit. Liria nga dëshira, liria nga frika dhe liria e gjeneratave të ardhshme për të trashëguar një mjedis të shëndetshëm natyror - këto janë blloqet e ndërlydhura që ndërtojnë sigurinë njerëzore – e rrjedhimisht edhe atë kombëtare.”<sup>271</sup>

Pra rrjedhimisht, vijmë në një përfundim, se edhe pse fokusi i sigurisë njerëzore ndryshon nga ai i sigurisë kombëtare, të dyja janë të lidhura ngushtë. Siguria njerëzore është shumë e rëndësishme jo vetëm për mirëqenien e vendit, por edhe për sigurinë kombëtare, stabilitetin dhe zhvillimin e përgjithshëm dhe përfundimisht për të patur një popullsi të shëndoshë dhe një mirëqenie stabile.

I gjithë fokusi politik dhe ai shoqëror, sa i përket çështjes së sigurisë e thamë dhe me lartë ka qenë i fokusuar në krijimin e një Force të Armatosur të Kosovës (kjo ndoshta edhe si pasojë e asaj që shoqëria kosovare ka kaluar dy dekada më herët).

Duke qenë të përqëndruar vetëm në këto dy çështje, edhe politika edhe shoqëria në përgjithësi, sa i përket sigurisë njerëzore, të cilat nëse nuk analizohen dhe trajtohen mirë me strategji si në të kaluarën gjithmonë në kordinim me NATO-n dhe Bashkimin Europian mund të përbëjnë kërcënim serioz për sigurinë kombëtare në tërësi.

Siguria kombëtare dhe qasja ndaj kundërshtimit të terrorizimit të dhunshëm deri më tani ka arritur të adresojë një nga çështjet potenciale kryesore për Kosovën, kriza e identitetit të një popullsie kryesisht të re që është në procese për integritet Europian.

Përderisa qëllimi i një vendi të ri si Kosova duhet të jetë bërja e shtetit të aftë dhe të gatshëm për përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të veta ndaj qytetarëve të vet, Kosovës i mbeten ende punë të mëdha në fusha të ndryshme socio-ekonomike.

Këto detyra i bëjnë qytetarët kosovarë edhe më të vendosur, sidomos në një mjedis ku stabiliteti politik është në nivelin të kënaqshëm duke bërë që Kosova më ndihmë e miqëve të saj Europian dhe ndihmës Amerikanë ka një të ardhmë të ndritur ne familjen Europiane.

Pra rekomandimi ynë është se politika dhe përgjegjësit politik në këtë vend, duhet të bëjnë përparime, avancimë të krijojnë politika të reja dukë parë gjithashtu dhe historinë të shkojnë drejt stabilitetit të sigurisë së lartë për vetë Kosovën, gjithashtu ndihmë të madhe fqinjëve të saj në ruajtjen e sigurisë në rajon.

<sup>271</sup> The Global Development Research Center, fq. 1

### **PËRFUNDIM**

Duke dashur ti tejkalojë përkufizimet konvencionale mbi sigurinë, dua të theksoj se fakti se sa qytetarët e vendit ndjehen të sigurt ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve që vlerësohen me probabilitet dhe impakt në vendin tonë, tregon edhe nivelin e sigurisë në vend.

Kjo nuk mund të ndërlihet vetëm me natyrën konvencionale të cenimit të sistemit të sigurisë së një vendi por edhe me shumë fenomene dhe zhvillime të karakterit asimetrik nga fusha të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë. Këtu hyjnë edhe arsimimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, stabiliteti politik, fenomene si korrupsioni, krimi organizuar, mungesë e dijeve profesionale shkencore e dukuri tjera.

Kosova e pasluftës në dekadën e parë të pavarësisë së sajë, ka kaluar nëpër një ambient sfidues sigurie tejet fragjil dhe të cenueshëm por tw kapwrcyeshwm me sukses.

Ky fragjilitet nuk ka qenë rezultat vetëm i mungesës së kapaciteteve përkatëse vendore për t'iu kundërvënë rreziqeve dhe kërcënimeve që e kanë lënduar ambientin e sigurisë, sa kanë qenë edhe vet politikat shtetërore që kanë arritur të tejkalojnë konstelacionin ndërkombëtarë në të cilin e ka ndërtuar identitetin e vete shtetëror, sovranitetit politik, identitetit territorial dhe raportit me pozicionimin e vendeve që e nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, mekanizmave të sigurisë ndërkombëtarë si NATO, BE, OKB si dhe vet Pranisë Ushtarake Ndërkombëtare në Kosovë.

### **LITERATURA**

- [1] Ministrisë së Jashtme të Kosovës
- [2] The Global Development Research Center, fq. 1
- [3] <http://www.kosovopolice.com/>
- [4] <http://www.mksf-ks.org/>